

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
2024**

Nr. Rendor¹	Data e kërkesës²	Objekti i kërkesës³	Data e përgjigjes⁴	Përgjigje⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës⁶	Tarifa⁷
1.	04.01.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Bashkëlidhur do të gjeni Kërkesën për informacion. Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj, Faleminderit për bashkëpunimin.</p> <p>Përshëndetje,</p> <p>Në redaksinë tonë kanë mbërritur disa denoncime në lidhje me depozitimin e një grumbulli të madh plehrash dhe inerte nga kantieret e ndërtimit të disa objekteve jashtë rrethimit të tyre, i cili ndodhet në rrugën Filip Jano në Tiranë.</p> <p>Në vijim të bashkëpunimit me të gjitha institucionet shtetërore dhe duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkojmë informacion si më poshtë:</p>	11.01.2024	<p>Përshëndetje!</p> <p>Në vijim të kërkesës tuaj, ju informoj se kërkesa është deleguar për trajtim në Drejtorinë Rajonale IKMT Tiranë, por për arsye të transferimit të zyrave kërkojmë mirëkuptimin tuaj në lidhje me vonesat.</p> <p>Ditë të mbarë!</p>	Kthim përgjigje (11.01.2024)	Nuk ka

		<p>A ka kryer IKMT-ja inspektime/kontrolle periodike në këtë zonë (kantiere ndërtimi) në përputhje me planet e miratuara vjetore?</p> <p>Nëse po, a janë marrë masa nga Inspektoriati për subjektet që kanë shkaktuar këtë ndotje nga ndërtimet në territorin e Bashkisë Tiranë?</p> <p>Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin,</p> <p>Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana Juaj,</p>				
2.	22.01.2024	<p>Me përgjigjen e datës, 28.12.2023 të Inspektoratit Kombëtare të Mbrojtjes së Territorit me është komunikuar zyrtarisht se me anë të shkresës nr. 1164/4 prot. datë, 13.12.2023 i është kërkuar për kompetencë IVMT pranë Bashkisë Lezhë zgjidhja përfundimtare e problematikës së ngritur nga ana ime. Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkoj të dhëna të regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik nga institucioni</p>	02.02.2024	<p>Përsëndetje!</p> <p>Bashkëlidhur po ju dërgoj shkresën 1139 prot. datë 02.02.2024 në lidhje me trajtimin e problematikes së përcjellë nga z..</p> <p>Faleminderit!</p> <p>.</p>	Kthim përgjigje (02.02.2024)	Nuk ka

		<p>i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nëse është përcjellur nga IVMT pranë Bashkisë Lezhë informacioni i detajuar i kërkuar me anë të shkresës nr. 1164/1 prot. datë, 13.12.2023. ose me pak fjalë kërkoj nëse i është kthyer përgjigje shkresës nr. 1164/1 prot. datë, 13.12.2023 nga institucioni i IVMT pranë Bashkisë Lezhë. Duke ju falenderuar, mbetem në pritje të një përgjigjeje nga ana e institucionit tuaj.</p>				
3.	23.04.2024	<p>Pershendetje.</p> <p>Me që po ju shkruaj jam Agjent në një kompani sigurimesh në Doganen e Muriqanit. Kemi pasur kioskat 150 meter larg doganes dhe me urdhërin e Ministres në korrik 2023 jemi larguar nga IKMT pasi dokumentacioni nuk ishte i saktë për vendosjen e kioskave dhe jemi vendosur rreth 400 metra larg doganes konkretish tek resort Celiku që ka dhe dokumentat e sakta dhe për këtë në paguajm taksat dhe qeran. Dhe një nga kioska e Kompanis Eurosig është akoma e vendosur aty pra 150 meter larg nga dogane dhe po vazhdon në konkuron pa asnjë dokument kjo gjë nuk ka qene e drejt nga ana e IKMT.</p>	06.02.2024	<p>Përshendetje</p> <p>Bashkëlidhur po ju dërgoj shkresën nr. 1256 prot. datë 06.02.2024 në lidhje me trajtimin e problematikës së përcjellë nga.</p> <p>Faleminderit!</p>	Kthim përgjigje (06.02.2024)	Nuk ka

		<p>Kërkoj nga ju ose të zhvendoset edhe ajo tek ne ose te largohet nga aty sepse kjo i bie njeri i nënës dhe të tjerët të njerkes. ju lutem shikoni këtë pasi ne po paguajm cdo detyrim ndaj shtetit.</p> <p>Në pritje të një zgjidhje nga ana juaj Faleminderit</p>				
4.	31.01.2022	<p>Përshëndetje,</p> <p>U njohëm me përgjigjen tuaj sipas portalit.</p> <p>Lutem na vendosni në dispozicion një kopje të dokumentacion të dorëzuar nga në datë 23.01.2024 pranë IKMT - Elbasan dhe të cituar nga ju “Nga ana e pranë protokollit të IKMT-Dr.Elbasan më dt.23.01.2024, është dorëzuar një kërkesë bashkëngjitur edhe vendimi nr.Regj.Them.5754(31151-08262-80-2023, datë 03.11.2023, të Gjykatës Administrative Shkallës Parë Tiranë, ku është vendosur: Pranimi e kërkesës për marrje mase sigurim padie. Pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ vendim nr.17 serie 0000017 datë17.05.2023, për prishjen e objektit të</p>	02.02.2024	<p>Përshëndetje ,</p> <p>Drejtuar: Inspektoriati i Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Elbasan IKMT Drejtoria Elbasan</p> <p>Në adresën e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit të sipërcituar paraqitur nga për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj.</p> <p>Faleminderit!</p>	<p>Deleguar përr kompetencë: IMT Bashkia Elbasan, IKMT Elbasan Deleguar (02.02.2024)</p>	Nuk ka

		<p>kundraligjshëm të Inspektoriati të Mbrojtjes Territorit Bashkia Elbasan ”.</p> <p>Kërkojme vemendjen tuaj për këtë kërkesë për informacion pasi patja e një kopje të vendimit nr.Regj.Them.5754 që është depozituar pranë IKMT Elbasan është e nevojshme për adresimin e çështjes në gjykatë si palë.</p> <p>Shume faleminderit,</p>				
5.	13.02.2024	<p>Çfare leje duhet për të ndërtuar një objekt si në foton me poshtë pa themele, beton apo solete.</p> <p>Faleminderit!</p>	13.02.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana juaj, ju bëjmë me dije se lejet të kësaj natyre jepen nga Autoritetet Vendore (Bashkisë ose Njësisë Administrative, ku ju doni të ndërtoni), Prandaj dhe informacionin për lejen mund ta merrni pranë tyre.</p> <p>Faleminderit!</p>	Për Autoritetin Vendor (13.02.2024)	Nuk ka
6.	13.02.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Ju njoftojme se çështja me palë paditëse Ferdinand Likaxhiu dhe palë e paditur IKMT Tiranë, Shoqëria Përmbartimore Private "Vako& Partners Bailiff Service" shpk do të shqyrtohet në dhomë këshillimi me datë 29.02.2024.</p>	13.02.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në adresën e-mailit të koordinаторit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur njoftimi nga Gjykata e Lartë, në lidhje me informimin e-mailit me nr. 6 rendor, datë, 13.02.2024, bashkëlidhur po Ju përcjellim njoftimin e paraqitur</p>	Dërguar DRIKMT Tirane, mbi njoftimin (13.02.2024)	Nuk ka

		Sekretaria gjyqësore		<p><i>"Se çështja me palë paditëse Ferdinand Likaxhiu dhe palë e paditur IKMT Tiranë, Shoqëria Përmbartimore Private "Vako & Partners Bailiff Service" shpk do të shqyrtohet në dhomë këshillimi me datë 29.02.2024"</i></p> <p>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.</p>		
7	15.02.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Unë jam kerkuesi. Lutem gjeni bashkëlidhur kërkesën për informacion (në versionin e nënshkruar dhe në versionin word për lehtësi punimi mbi materialin).</p> <p>Për çdo pyetje apo qartësim, lutem më kontaktoni në emailin Informacionin lutem përcillen po në këtë email.</p> <p>Ju falenderoj,</p>	23.02.2024	<p>Përshëndetje!</p> <p>Në vijim të e-mailit tuaj, me objekt "Kërkesë për informacion", pasi u shqyrtua materiali i dërguar i cili duhet të plotësohet nga ana jonë, rezulton se pyetjet e hartuara konsistojnë për institucione të cilat funksionojnë sipas ligjit për nëpunësin civil.</p> <p>Përsa më sipër, ju informojmë se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, në lidhje me emërimet dhe largimet nga puna, funksionon sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Punës dhe jo sipas ligjit për nëpunësin civil.</p> <p>Duke ju falënderuar,</p>	Kthim përgjigje (23.02.2024)	Nuk ka
8	21.02.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në bazë të ligjit për të drejtën e informimit nr. 119/2014, jeni të detyruar të jepni informacion për gazetaret.</p>	06.03.2024	<p>Përshëndetje!</p> <p>Në lidhje me kërkesat tuaja për informacion, sa lidhet me dijeninë e DRIKMT Tiranë nëse nga subjektet</p>	Deleguar IMT, Bashkia Tiranë (29.02.2024)	Nuk ka

		<p>Nëse ju refuzoni të përgjigjeni do ti drejtohem Komisionerit për të Drejtën e Informimit.</p> <p>Ju faleminderit</p>	<p>e cilësuar nga ana juaj administrohet për përdorim leje e posaçme e hapësirës publike jashtë kantierit, apo nëse punët janë realizuar në përputhje me planin e organizimit ju bëjmë me dije se:</p> <p>Plani i organizimit të punimeve në kantierin e ndërtimit, si koncept është një dokument i rëndësishëm që përcakton se si do të zhvillohen punimet gjatë ndërtimit të një objekti duke përfshirë elementët e ndërtesës si rrugët e përkohshme, rrethoja, instalimet e përkohshme, zyrat e përkohshme dhe depot. Ndërsa sa lidhet me dhënien e lejes për përdorim të hapësirës publike është Njësia Vendore autoriteti përkatës.</p> <p>Për sa më sipër ju sqarojmë se në përputhje dhe në zbatim të nenit 4 dhe 5 të ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, V.K.M-së Nr. 894, datë 04.11.2015, “Për Unifikimin e Proçedurave të Kontrollit të Territorit”, autoriteti përgjegjës që konkretisht ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike</p>		
--	--	---	--	--	--

				<p>e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, është IMT Bashkia Tiranë.</p> <p>Lutemi adresimin e kërkesës suaj pranë këtij inspektorati.</p> <p>Duke ju falenderuar jemi të hapur për çdo kërkesë që lidhet me objektin e IKMT, punë të mbarë!</p>		
9	23.02.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Ju falenderoj për komunikimin.</p> <p>Vetëm pyetja 3 (dhe 3.1) i referohen statusit të nëpunësit civil. Lutem për 3 pyetjet e tjera mund të përcillni informacionin?</p> <p>Punë të mbarë,</p>	07.03.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Nëpërmjet këtij e-maili dëshirojmë t'iu informojmë me shkresën nr. 2110 Prot., datë 07.03.2024 në lidhje me problematikën tuaj, trajtuar nga Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit, të cilën po ua përcjell nëpërmjet këtij e-maili.</p> <p>Ju falenderojmë paraprakisht për mirëkuptimin.</p>	Kthim përgjigje (07.03.2024)	Nuk ka
10	27.02.2024	<p>Pershendetje,</p> <p>Ju falenderoj për informacionin e përcjellë.</p> <p>Lutem gjeni bashkelidhur një kërkesë për informacion me 2 pyetje të cilat janë të lidhura me kërkesën e parë.</p>	07.03.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Nëpërmjet këtij e-maili dëshirojmë t'iu informojmë me shkresën nr. 2110 Prot., datë 07.03.2024 në lidhje me problematikën tuaj, trajtuar nga Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit, të cilën po ua përcjell nëpërmjet këtij e-maili.</p>	Kthim përgjigje (07.03.2024)	Nuk ka

		Faleminderit,		Ju falenderojmë paraprakisht për mirëkuptimin.		
11	25.03.2024	<p>Emisioni Investigativ "PLUG" do të trajtoje një temë shumë të rëndësishme, atë të ndërtimeve pa leje në Shqipëri. Në datën 07.09.2022 është miratuar VKM "589", "Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi".</p> <p>Në piken 6 të vendimit përcaktohet se, "Procedura e konfiskimit për interes publik sipas këtij vendimi fillon me propozimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, në vijim të inspektimeve periodike të kryera kryesisht apo pas marrjes së njoftimit nga IMT-javendore sipas fushës së përgjegjësisë, në përputhje me legjislacionin".</p> <p>Kërkojme nga ju informacionin si më poshtë vijon :</p>	09.04.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Nëpërmjet këtij e-maili dëshirojmë t'iu informojmë në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana juaj, trajtuar nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, të cilën po u'a përcjell nëpërmjet këtij e-maili.</p> <p>Ju falenderojmë paraprakisht për mirëkuptimin.</p>	Kthim përgjigje (09.04.2024)	Nuk ka

	<p>1- Të gjitha propozimet e IKMT drejtuar KKT bazuar në këtë VKM.</p> <p>2- Sa nga këto shkelje janë konstatuar nga institucioni juaj dhe sa nga</p> <p>IMT vendore.</p> <p>3- Sa nga këto subjekte janë përsëritës të kësaj vepre penale.</p> <p>4- Sa kallëzime ka bërë institucioni juaj për këtë vepër dhe për cilat subjekte.</p> <p>5- Akt konstatimet e mbajtura për ndërtimin pa leje " Godine banimi dhe shërbime 1,2,3.4,5 dhe 6 kat, me 2 dhe 4 kate parkimi nëntoke", me vendndodhje në RR. "Hiqmt Buzi", Bashkia Tirane, me zhvillues shoqerite "Xheluks Construction" dhe "Devis Konstruksion". A ka patur leje të mëparshme ndërtimi apo është ndëruar në paligjshmëri të plotë.</p> <p>Procesverbali i gjobës dhe pagesa e subjetit. Ligji parashikon dhe ndjekjen penale për këtë këtë subjekt, a është kallzuar penalisht nga</p>				
--	--	--	--	--	--

	<p>institucioni juaj.</p> <p>6- Akt konstatimet e mbajtura për ndërtimin pa leje " Godinë banimi dhe shërbime 6 kat, me 2 dhe 4 kate parkimi nëntoke", me vendndodhje në RR. "Hiqmt Buzi", Bashkia Tirane, me zhvillues shoqëritë "Xheluks Construction" dhe "Laxmi Real Estate". A ka patur leje të mëparshme ndërtimi apo është ndëruar në paligjshmeri të plotë. Procesverbali i gjobës dhe pagesa e subjettit. Ligji parashikon dhe ndjekjen penale për këtë këtë subjekt, a është kallzuar penalisht nga institucioni juaj.</p> <p>7- Akt konstatimet e mbajtura për ndërtimin pa leje " Objekt 7 kate, me 2 kate nëntoke, të ndërtuar pa leje për qëlim fitimi, brenda sheshit të ndërtimit të objektit "Godinë banimi dhe shërbime 1,2,3.4,5 dhe 6 kat, me 2 dhe 4 kate parkimi nëntokë", me vendndodhje ne RR. "Hiqmt Buzi", Bashkia Tirane, me zhvillues shoqëritë "Xheluks Construction" dhe "Devis</p>				
--	---	--	--	--	--

		<p>Konstruksion". A ka patur leje të mëparshme ndërtimi apo është nderuar në paligjshmëri të plotë. Procesverbali i gjobës dhe pagesa e subjettit.</p> <p>Ligji parashikon dhe ndjekjen penale për këtë këtë subjekt, a është kallzuar penalisht nga institucioni juaj.</p> <p>8- Akt konstatimet e mbajtura për ndërtimin pa leje " Kompleks me godina banimi dhe shërbime 4,5,6 dhe 7 kat, , me 2 kat nëntoke", me vendndodhje ne RR. "Hiqmt Buzi", Bashkia Tiranë, me zhvillues shoqërite "Xheluks Construction" dhe "City Construction INC". A ka patur leje të mëparshme ndërtimi apo është nderuar në paligjshmëri të plotë. Procesverbali i gjobës dhe pagesa e subjettit. Ligji parashikon dhe ndjekjen penale për këtë subjekt, a është kallzuar penalisht nga institucioni juaj.</p> <p>9- Akt konstatimet e mbajtura për ndërtimin pa leje " Objekt shërbimi 2 kate" me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himare, me</p>				
--	--	--	--	--	--	--

	<p>zhvillues Arton dhe Adrian Vezi. A ka patur leje të mëparshme ndërtimi apo është ndëruar në paligjshmeri të plotë. Procesverbali i gjobës dhe pagesa e subjettit. Ligji parashikon dhe ndjekjen penale për këtë këtë subjekt, a është kallzuar penalisht nga institucioni juaj.</p> <p>Ligji Nr. 107/2014, në nenin 52 pika 5 parashikon "Për shkeljet e kryera nga subjekti ndërtues, projektuesi, mbikëqyrësi dhe kolaudatori, strukturat e kontrollit paraqesin menjëherë kërkesën për heqjen e licencës. Autoritetet përkatëse janë të detyruar të marrin vendim për heqjen e licencës brenda pesë ditëve. Subjekti, të cilit i është hequr licenca, nuk mund të pajiset më me të njëjtën licencë për 5 vitet në vijim". Kërkesat për heqjen e licenses së subjekteve objekt i VKM 589.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,</p>				
--	--	--	--	--	--

12	25.03.2024	<p>Përshëndetje të gjithëve!</p> <p>Nga European Union Network for the Implementation and Enforcement of Environmental Law (IMPEL) dhe konkretisht nga projekti “Geospatial Intelligence for Environmental Damage Assessment (GIEDA) është kërkuar të shpërndahen pyetësoret dhe të plotësohen nga institucionet që kane mundesi për dhënjen e përgjigjeve në lidhje me informacionin e kërkuar.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni: linku 1 për pyetësonin e parë https://forms.office.com/r/vhEH13eLfk?origin=lprLink</p>	08.04.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Bazuar në emailin ku kërkohet plotësimi i pyetësorit në lidhje me informacionin e kërkuar, ju bëjmë me dije se pyetësori është plotësuar dhe dërguar me datë 25.03.2024.</p> <p>Ju falenderojmë paraprakisht për mirëkuptimin.</p>	Kthim përgjigje (26.03.2024)	Nuk ka
13	09.04.2024	<p>Në zbatim te ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kerkoj te dhëna të regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik nga institucioni i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në lidhje me: 1. Përgjigjen e institucionit të IVMT pranë Bashkise Lezhë për informacionin e dënë zyrtarisht në përgjigje të shkresës së IKMT me nr. 4503 datë, 11.10.2022, të me vihet në dispozicion përgjigjja zyrtare e IVMT pranë Bashkisë Lezhë, 2. Venien në dispozicion</p>	09.04.2024	<p>Përshëndetje ,</p> <p>Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Lezhë</p> <p>Në adresën e e-mailit të koordinatorsit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa me nr. 13 Rendor, datë 09.04.2024, për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>Bashkëlidhur po ju përcjellim kërkesën e paraqitur nga</p>	Deleguar IMT, Bashkia Lezhë (09.04.2024)	

		<p>të procesverbaleve të konstatimit nëse janë mbajtur nga IKMT gjatë trajtimit të ankesës time, në terrenin e kryerjes së punimeve apo në dokumentacionin që ka mbajtur IVMT pranë Bashkisë Lezhë në shqyrtim të ankimit tim.</p> <p>Duke ju falenderuar, mbetëm në pritje të një përgjigjeje nga ana e institucionit tuaj.</p>		<p>Lutemi në trajtimin e kërkesës së sipërcituar, si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të lëshuar nga institucioni juaj.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,</p>		
14	12.04.2024	<p>FTESË Konferenca prezantuese e Barometrit Kombëtar të Komitetit Shqiptar të Helsinkit</p>	12.04.2024	<p>Përhëndetje Z. Kryeinspektor,</p> <p>Bashkëlidhur po ju dërgoj e-maili ftesën e ardhur për Konferencën Prezantuese e Barometrit Kombëtar të Komitetit Shqiptar të Helsinkit me objekt: "Prezantojmë Barometrën Kombëtar të hartuar nga KShH, i cili bazohet tërësisht në gjetjet e rezultuara nga sesionet e monitorimit të ekipit të KShH, ndërthurur me Mbrojtës të rinj të Drejtave të Njeriut të trajnuar në metodologjinë e KShH, si dhe në gjetjet e ardhura nga pyetësorët e realizuar me qytetarë të zgjedhur në mënyrë të rastësishme në nënte tematika gjithëpërfshirëse të të drejtave të njeriut".</p> <p>Faleminderit!</p>	<p>Njoftuar me email nga Burimet Njerezore të gjithe stafit IKMT</p>	
15	12.04.2024	<p>Përhëndetje,</p> <p>Duke ju falenderuar për</p>	13.06.2024	<p>Të nderuar,</p>	<p>Kthim përgjigje</p>	

		<p>përgjigjen, dojm tju rikujtonim se kemi kërkuar informacion shkresor dhe jo narrative.</p> <p>Kemi kërkuar nga ju:</p> <p>1- Të gjitha Akt-Konstatimet e mbajtura për subjektet. 2- Proçesverbalet e gjobave dhe pagesat e subjekteve. 3- Komunikimin shkresor me Ministrine e linjes për heqjen e licensave të subjekteve të gjetura me shkelje. 4- Propozimet e IKMT drejtuar KKT-së.</p> <p>Me shpresën e një përgjigje të plotë për kërkesat tona.</p> <p>Punë të mbarë,</p>	<p>Ju falenderojmë për interesimin tuaj në lidhje me temën e ndërtimeve pa leje dhe për kërkesën për informacion. Pas shqyrtimit edhe një herë të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neni 6, paragrafi 1, çdo përpunim i të dhënave personale duhet të kryhet vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij të qartë dhe të informuar, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Ky ligj siguron mbrojtjen e të dhënave personale dhe kufizon shpërndarjen e informacionit që përmban të dhëna personale ose të ndjeshme <u>pa pëlqimin e palëve të përfshira.</u></p> <p>Dokumentet që keni kërkuar përmbajnë të dhëna personale dhe të ndjeshme të individëve dhe subjekteve të përfshira, shpërndarja e të cilave kërkon pëlqimin e individëve ose subjekteve. Në këto kushte, bazuar në ligjin e mësipërm, institucioni</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>nuk mund të shpërndajë informacionin e kërkuar.</p> <p>Jemi të angazhuar për të respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale paralelisht me legjislacionin për të drejtën e informimit dhe për të siguruar që çdo përpunim dhe shpërndarje e të dhënave të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>Lutemi ti referoheni përgjigjes sonë të datës 09.04.2024 për të gjithë informacionin për masat e marra nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për secilën pikë të kërkuar nga ana juaj.</p> <p>Ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.</p> <p>Me respekt,</p>		
16	17.05.2024	<p>Te nderuar ne vijim te pergjigjes tuaj ne lidhje me kerkesen time per informacion jeni shprehur se dy dokumentat e kerkuar nga ana ime jane te IMT prane Bashkise Lezhe.</p> <p>Kerkesa ime per informacion eshte bere per te me vene ne dispozicion procesverbalet e</p>	31.05.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Referuar problematikës së ngritur nga ju kemi informuar se IMT-Bashkia Lezhë ka ushtruar kontroll asokohe për ankesën e përcjellur nga ana juaj dhe për punimet që po kryhen është shprehur se ... është i pajisur me leje nga Drejtoria e</p>	Deleguar IKMT Lezhe Pergjigje datë 31.05.2024	

		<p>konstatimit nga ana IKMT pasi me ane te shkreses se IKMT te dates, 25.03.2024 me jane komunikuar keto konstatime te IKMT si:</p> <p>Jane kryer punime te maskuara per te cilat nuk jane mbajtur libreza masash e fotografi, kerkoj procesverbalet e mbajtura nga IKMT per nje konstatim te tille. Nuk eshte e mundur sipas IKMT te pasqyrohen me saktësi volumet apo nderhyrjet ne shkelje te lejes se dhene, kerkoj procesverbalet e mbajtura nga IKMT per nje konstatim te tille se besoj nuk mund te konstatohet pamundësia pa dokumentuar te dhenat nga terreni te pamundesise se pasqyrimet, cilat jane elementet kufizues qe sjellin pamundesine apo konstatimet e shkreses se IKMT se dates, 25.03.2024 nuk jane ne baze te nje verifikimi ne terren.</p>		<p>Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Lezhë.</p> <p>Gjithashtu ju kemi informuar se ne nuk jemi vënë në dijeni të problematikës së ngritur nga ana juaj në kohën kur po kryheshin punimet por 2 vite më vonë , e duke qënë se në kohen e kryerjes së punimeve janë kryer punime të maskuara për të cilat nuk janë mbajtur libreza masash e fotografi gjatë procesit të punës sipas fazave përkatëse nuk është e mundur sot të pasqyrojmë me saktësi volumet apo ndërhyrjet në shkelje të lejes së dhënë dhe në këtë rast nuk disponojme Proces Verbal Për Konstatimin e Kundravajtjes.</p> <p>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!</p>		
17	20.05.2024	<p>Nisur nga fakti i mos aksesimit të akteve ligjore të I.K.M.T (sektori i ndërtimeve të paligjshme),do ta vleresoja nese i dergoni (qoftë edhe vetëm me përshkrim) me qëllim që të përditësuara të mund ti aksesoj nga Qendra e Botimeve Zyrtare (online).</p>	03.06.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Aktet ligjore me emërtime (Ligji nr. Xx data xxxx) mund ti gjeni te listuara ne faqen e ikmt.gov.al ne seksionin legjislacioni, Akte Ligjore, Aktet Nenligjore, përkatësisht ne link https://ikmt.gov.al/akte-ligjore/ https://ikmt.gov.al/akte-nenligjore/ .</p>	Kthim pergjigje 20.05.2024	Nuk ka

		Ju faleminderit		Ne rast problemi, lutem provoni te aksesoni këto link ne browserin Microsofte Edge, ku mund te shkarkoni dokumentat ne formatin PDF. Faleminderit		
18	02.06.2024	<p>Të nderuar,</p> <p>Duke ju uruar punë të mbarë, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, lutem të më informoni për</p> <p>sa më poshtë vijon:</p> <p>1. A ka përdorur institucioni juaj në ndonjë rast informacione vizuale të ardhura nga satelitët “Albania 1” dhe “Albania 2” për të luftuar ndërtimin e paligjshëm apo kundërvajtje të tjera në fushën tuaj të përgjegjësisë?</p> <p>2. Nëse po ju lutem specifikoni numrin e rasteve dhe rastet që ju mund të jeni ndihmuar nga imazhet satelitore.</p> <p>Ju faleminderit.</p>	03.06.2024	<p>E nderuar Znj.,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion të datës 02.06.2024 në lidhje me përdorimin e sateliteve Albania 1 dhe Albania 2 nga Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT) ju informojmë si më poshtë vijon.</p> <p>Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT) ka bashkëpunuar ngushtë me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG). Deri më tani IKMT nuk i ka përdorur satelitët në funksion të përmbushjes së misionit të Institucionit për mbrojtjen e territorit.</p> <p>Nëpërmjet sistemit Arc-GIS Online, na është dhënë mundësia në përdorimi e imazheve satelitore në fushën e inspektimit të mjedisit, ujërave, pyjeve dhe ndërtimit, me fokus të veçantë në vijën bregdetare. Për çdo kërkesë</p>	Kthim pergjigje, 04.06.2024	Nuk ka

				<p>specifike të IKMT-së, ASIG përgatit grupin e punës për përpunimin e informacionit satelitor, të cilin e përdorim sidomos në raste kur aksesimi i terreneve të vështira është i pamundur.</p> <p>Aktualisht jemi në fazën e trajnimit të inspektoreve të IKMT dhe testimit të sistemeve tona të reja për përdorimin e imazheve satelitore nga satelitet Albania 1 dhe Albania 2.</p> <p>Jemi në dispozicionun tuaj për informacion të mëtejshme.</p> <p>Duke ju falenderuar.</p>		
19	24.06.2024	<p>Pershendetje! Kam bere nje ankese ne portalin e-albania date 12.06.2024 me numer aplikimi: MB-2024-3776650-UU Por nuk kam asnje pergjigje! Faleminderit!</p>		<p>Përhëndetje, Referuar kërkesës suaj për informacion ju informojmë se ankesa juaj me numër aplikimi: MB-2024-3776650-UU është në process trajtimi nga DRIKMT Elbasan. Përgjigja për aplikim tuaj do tju vihet në dispozicion nëpërmjet portalit e-albania.</p> <p>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!</p>	Kthim pergjigje 24.06.2024	Nuk ka
20	28.06.2024	<p>Ju lutem na vendosni ne disapozicion, numrin e rasteve ne te cilat Inspektorati Kombetar i</p>		<p>1. Pyetja: Ju lutem na vendosni në dispozicion, numrin e rasteve në të cilat Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së</p>	Kthim pergjigje 05.07.2024	

		<p>Mbrojtjes se Territorit ka perdorur te dhenat (imazhet, video etj) e prodhuara nga satelitet Albania 1 dhe Albania 2.</p> <p>2. Sa punonjes jane te trajnuar ne strukturat e Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit per te lexuar te dhenat e perftuara nga satelitet Albania 1 dhe Albania 2?</p> <p>3. Kur jane zhvilluar dhe sa kane zgjatur keto trajnime te personelit nese jane realizuar dhe cila ka qene kostoja e tyre?</p> <p>4. Ju lutem na vendosni ne dispozicion se ne sa raste jane perdorur dhe per cfare jane perdorur te dhenat e perftuara nga satelitet Albania 1 dhe Albania 2 nga strukturat ne varesi Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit</p> <p>5. Ju lutem na vendosni ne dispozicion se cfare te dhenash perfton dhe perdor Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit ne te gjitha strukturat e tij nga Satelitet Albania 1 dhe Albania 2?</p>		<p>Territorit ka perdorur te dhenat (imazhet, video etj) e prodhuara nga satelitët Albania 1 dhe Albania 2.</p> <p>Përgjigje: Po, kemi pasur një rast në Gramsh/Liqeni i Banjës, ku janë përdorur imazhet satelitore për identifikimin e punimeve të shesh pushimit.</p> <p>2. Pyetja: Sa punonjës janë të trajnuar në strukturat e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për të lexuar të dhënat e përfuara nga satelitët Albania 1 dhe Albania 2?</p> <p>Përgjigje: Nga strukturat e IKMT janë trajnuar 4 (katër) punonjës. 1 (një) punonjës nga Drejtoria e Informacionit, Kontrollit të të Dhënave dhe Marrëdhënieve me Publikun, 1 (një) punonjës nga Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, 1 (një) punonjës nga Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve, si dhe 1 (një) punonjës nga Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit.</p> <p>3. Pyetja: Kur janë zhvilluar dhe sa kanë zgjatur këto trajnime të</p>		
--	--	---	--	---	--	--

				<p>personelit, nëse janë realizuar, dhe cila ka qenë kostoja e tyre?</p> <p>Përgjigje: Der më tani është kryer 1 (një) trajnim ditor, i cili është organizuar dhe kryer në ambientet e Autoritetit Shqiptar për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), me datë 31.05.2024.</p> <p>4. Pyetja: Ju lutem na vendosni në dispozicion se në sa raste janë përdorur dhe për çfarë janë përdorur të dhënat e përfutuara nga satelitët Albania 1 dhe Albania 2 nga strukturat në varësi të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.</p> <p>Përgjigje: Është përdorur vetëm në një rast nga Drejtoria e Inspektimit dhe Planifikimit të Territorit për evidentimin e punimeve të sheshpushimit në rrugën Panoramike në Liqenin e Banjës/Gramsh. Deri më tani, kjo platformë e imazheve satelitore po testohet dhe përdoret vetëm nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) Drejtoria Qendrore dhe do funksionojë në rast nevojë për</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>dhënie informacioni për 12 Drejtoritë Rajonale.</p> <p>5. Pyetja: Ju lutem na vendosni në dispozicion se çfarë të dhënash përfton dhe përdor Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në të gjitha strukturat e tij nga satelitët Albania 1 dhe Albania 2?</p> <p>Përgjigje: IKMT deri më tani ka qasje në të dhëna si: ortoimazheri, monitorime kamera 360 gradë, monitorime me UAV të zonës bregdetare, krahasime në hapësirën kohore prej 72 orësh për ndryshimet në terren, ndryshimet në zonat hidrike në gërryerjen e shtratit të lumenjve, ndotjen mjedisore, sidomos të burimeve hidrike, nëpërmjet sensorëve satelitorë.</p>		
21	18.07.2024	<p>I nderuar, Kordinator per te drejten e informimit prane I.K.M.T,</p> <p>Nisur nga ndryshimet ligjore të fundit te ligjit 107/2014,"Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar , dhe rregullores 408/2015 "për Miratimin e rregullores se Zhvillimit te Territorit",e</p>	01.08.2024	<p>Përsëndetje,</p> <p>Më poshtë do të gjeni kthimin e përgjigjes me nr. 21 rendor datë 18.07.2024.</p> <p>Lidhur me objektin e kërkesës tuaj mbi interpretimin ligjor të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, dërguar pranë IKMT – së në adresën e emailit të Koordinatorit për të</p>	<p>Kthim përgjigje 31.07.2024</p>	

		<p>ndryshuar, kemi disa paqartësi si mëposhtë ,e vlerësojme nëse do kthenit përgjigje;</p> <p>1) Pika 1 e nenit 52 të ligjit "Kundërvajtje administrative"</p> <p>1.Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, përveç rasteve kur përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:</p> <p>e)1 kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror, kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me:</p> <p>i. prishje të menjëhershme të ndërtimit pa leje në kushtet e flagrancës;</p> <p>Si do bëhet dallimi mes kundërvajtjes dhe rasteve që duhet të referohen si vepër penale "ndërtim i paligjshëm"?</p> <p>2) Nëse subjekti i kontrolluar është subjekt i nenit 52 pika d) e ligjit 107/2014 i ndryshuar (punimet qe kerkojne deklarate praprake)</p>	<p>Drejtën e Informimit, me nr. 21 rendor datë 18.07.2024 ju informojmë sa më poshtë vijon:</p> <p>Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektoratet e Mbrojtjes së Territorit pranë Pushtetit Vendor ushtrojnë funksionet e tyre ligjore në fushën e mbrojtjes së territorit sipas juridiksioneve dhe kompetencave të ndara administrativisht dhe ligjorisht (pavarësisht varësisë institucionale të tyre).</p> <p>Një nga fushat me karakter të përbashkët kontrolli është dhe fusha e kontrollit të zhvillimit të territorit me qëllim kontrollin, sensibilizimin dhe parandalimin e veprimeve të paligjshme dhe të paautorizuara ndërtimore, të cilat sanksionohen/përcaktohen nga një sërë dispozitash dhe aktesh nënligjore të zbatueshme (Ligji nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, i ndryshuar Ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, Ligji nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve në Ndërtim, Kodi i Procedurës Administrative, Ligji nr.10279 datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” Vendim nr. 894</p>		
--	--	---	--	--	--

		<p>d) mosdeklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje, sipas nenit 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 150 000 lekë</p> <p>Kur, konstatohet nga inspektorët, dhe ai pas lënies së detyrave nga inpektoret, aplikon për "Miratimin e Deklarates per kryerjen e Punimeve" brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit, sipas paragrafit të parë neni 13 i ligjit 9780/2007 i ndryshuar," PËR INSPEKTIMIN DHE MBROJTJEN E TERRITORIT NGA NDËRTIMET E KUNDËRLIGJSHME" dhe pezullon vullnetarisht punimet, a merret masë administrative gjobe për subjektin?</p> <p>Duke ju uruar punë të mbarë</p> <p>Mbetemi në pritje të orientimeve nga ana juaj!</p>	<p>datë 4.11.2015 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga IKMT dhe Ai i Njësisë Vendore”, Vendim nr. 408/2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar) apo dhe një sërë referencash ligjore të cilat harmonizohen dhe ndërlidhin kuadrin ligjor të zbatueshëm. Për sa i përket interpretimeve ligjore të kërkuara nga ana juaj theksojmë se;</p> <p>Legjislacioni shqiptar përveçse qartësisë së përmbajtjes dhe karakterit të tij normues dhe obligues, është i shoqëruar me akte dhe udhëzime ligjore të cilat sigurojnë mbarëvajtjen dhe zbatueshmërinë e tij, të cilat janë të orientueshme nga çdo dhe për çdo strukturë publike/private për efektet e saj.</p> <p>Interpretime ligjore të tjera ndaj të cilave duhen të bazohen çdo organ shtetëror (praktika gjyqësore përfundimatre) janë të publikurara apo të aksesueshme në Institucionet Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Ndër të tjera, fazat e zbatimit dhe implementimit të legjislacionit në përmbushje të detyrave funksionale lidhen me praktikën e përditëshme e cila shoqërohet me hetime</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>administrative ndaj çdo rrethane apo fakti të evidentuar dhe konstatuar nga ana juaj për të cilat proçedohet me masa administrative ligjore rast pas rasti.</p> <p>Gjithashtu, organet publike shtetërore, janë të konsoliduara me burime njerëzore dhe profesionale për detyrat që mbulojnë, detyrime ligjore këto të cilat përmbushen që në momentin e fazave rekretuese dhe zbatimit të saj.</p> <p>Nga sa më sipër përshkruam, duke qënë se objekti i kërkesës tuaj për interpretimin e legjislacionit në fushën e veprimtarive ndërtimore, nuk mund të përmbushet dhe të arrihet nga formati i një Kthim - Përgjigje me shkresë institucionale (orientuese) të pretenduar nga ana juaj, pasi është fakt evident (nga preçedenca të hasura nga çdo institucion me natyrë inspektuese) se natyra inspektuese ndërtimore ndiqet dhe shoqërohet nga një sërë dinamikash proçeduriale dhe administrative, për të cilën duhet të karakterizohet nga vullneti dhe angazhimi i strukturave tuaja mbi përmbushjen e detyrimeve dhe zbatimin e legjislacionit aktual në fuqi.</p> <p>Duke ju falenderuar për kontributin, rolin dhe bashkëpunimin Tuaj!</p>	
--	--	--	--	---	--

22	02.08.2024	<p>Te nderuar Zoterinj,</p> <p>Duke uruar te jeni mire, ju lutemi te kemi vemendjen tuaj ndaj kesaj Kerkese.</p> <p>Shoqeria Espana – Pharm sh.p.k., me NUIS: L22307018R, eshte nje shoqeri tregtare e regjistruar ligjerisht dhe fiskalisht sipas te drejtes shqiptare me objekt aktiviteti import – eksport, shitja, shperndarje etj..</p> <p>Ne kuader te aktivitetit te saj tregtar shoqeria ushtron aktivitet edhe ne Bulevardin Zogu i Pare, prane martanitetit te vjeter ne dyqanin me emertim “Baby Boo”.</p> <p>Ne te njejten adrese, ngjitur me aktivitetin tregtar te shoqerise, ushtron aktivitet tregtar Fast Food, i cili pasi ka kryer ndertimin e paligjshem per vendosjen jashte çdo rregulli te tubit te aspirimit, na e ka bere te pamundur punen dhe aktivitetin tone te perditshem ne dyqan nga ndotja, zhurmat e padurueshme, ererat dhe temperaturat e larta qe shkakton ky objekt.</p> <p>Pas perpjekjeve per ta zgjidhur kete situatë me bisedime, as</p>	02.08.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në adresën e e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa nga në zbatim të Ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, me nr. 22 Rendor, datë, 02.08.2024.</p> <p>Lutemi në trajtim të kërkesës sa më poshtë, si dhe referuar dhe shkresës së dërguar nga Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit me nr. 4573/1 prot., datë 18.07.2024 "Për kompetencë IMT Bashkia Tiranë.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,</p>	<p>Deleguar për kompetence IMT Bashkia Tiranë datë 02.08.2024</p>	
----	------------	--	------------	--	---	--

	<p>personi perfaqesues i Fast Food dhe as pronari i ambientit, nuk kane ndermarre asnje mase, madje duket se nuk jane shqetesuar aspak per kete problem.</p> <p>Pas ndjekjes se procedurave ligjore nga ana jone, u paraqit IMT Bashkia Tirane dhe me shkresen nr. 3932/1 prot., date 27.05.2024 na njofton se jane kryer verifikimet ne terren dhe eshte konstatuar kundravajtja: “Vendosje e tubit te aspirimit ne subjektin “Fast Food” pa dokumentacionin perkates tekniko-ligjor” per te cilen eshte mbajtur procedura:</p> <ul style="list-style-type: none">-) Procesverbal i konstatimit te kundravajtjes nr. 5967, date 02.05.2024-) Vendim per denimin me gjobe nr. 5538, date 10.05.2024-) Vendim per prishjen e objekti te kundraligjshem nr. 2781, date 10.05.2024. <p>Duke qene se kaloi kohe dhe askush nuk u paraqit per prishjen e objektit te kundraligjshem, paraqitem kallzim penal prane organit te Prokurorise per ndertimin e paligjshem dhe</p>				
--	---	--	--	--	--

	<p>njekohesisht u ankuam prane IKMT. IKMT veproji menjehere dhe ne pergjigje u pajisem me shkresen nr. 4573/1 prot., date 18.07.2024, derguar per kompetence IMT Bashkia Tirane. Sipas kesaj shkrese te IKMT kerkohet nga IMT Bashkia Tirane:</p> <p><i>“Marrja e masave te menjehershme per ekzekutimin e vendimit duke i dhene zgjidhje perfundimtare problematikes se ankuesit.”</i></p> <p>Per sa me siper, duke besuar plotesisht ne eksperiencen tuaj te gjate, ju lutemi me kete Kerkese te na mbeshtesni me qellim qe vendimi i prishjes se objektit te kundraligjshem te ekzekutohet sa me pare nga IMT Bashkia Tirane, pasi ne nuk po kryejme dot punen e perditshme prej disa kohesh tashme.</p> <p>Duke shpresuar se kjo kerkese e jona do te degjohet nga ana Juaj dhe do te ndermerren te githa masat e nevojshme per prishejn e shpejte te ketij tupi aspirimi, mbetemi me pershendetjet me te mira!</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>Ju urojem suksese te metejshme ne pune tuaj!</p> <p>Me konsiderate!</p>				
23	16.08.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Duke ju uruar punë të mbarë, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, lutem të më informoni për sa më poshtë vijon.</p> <p>Sa është numri i gjobave të vendosura nga institucioni juaj dhe sa është vlera financiare e tyre, në periudhat: Janar-maj 2023 Janar-maj 2024</p> <p>Nuk kërkohet kategorizimi i tyre sipas llojit të shkeljes, dhe aq klasifikimi gjeografik i tyre. Vetëm sasia numerike dhe totali i vlerës financiare për këto dy fasha 5-mujore.</p> <p>Sipas të drejtës që më jep ligji, këtë informacion dëshiroj ta marr vetëm në rrugë ELEKTRONIKE, siç edhe më sipër përcaktohet.</p> <p>Të dhënat e kërkuara do të përdoren si pjesë e një artikulli hulumtues gazetaresk.</p>	28.08.2024	<p>E nderuar,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion të datës 16.08.2024 në lidhje me kërkesën për gjobat Janar-Maj 2023 dhe Janar-Maj 2024 nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ju informojmë se të dhënat vijnë në format tabelar si më poshtë:</p> <p>Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,</p>	<p>Kthim përgjigje (28.08.2024)</p>	<p>Nuk ka</p>

		Ju faleminderit për bashkëpunimin.				
24	19.08.2024	<p>Kërkesë për informim</p> <p>Jam banor në pallatin 5, Bulevard Zhan Dark (Rruga Marsel Kashen). Kemi dalë nga banesa dhe ka dy ditë që po shembet shkalla 2 e pallatit.</p> <p>Pyesim në Bashkinë e madhe, në njësinë administrative 2, punëtorët që po bëjnë shembjen na përgjigjen nuk dimë gjë.</p> <p>Çfarë do të bëhet me ne ? A do të bëhet pallat i ri ? Sa do zgjasin procedurat ?</p> <p>Pse nuk është bërë akt marrëveshje me ne, kemi certifikate të rregullt pronësie, banojmë që në vitin 1972 në këtë pallat.</p> <p>Kërkojmë të informohemi.</p>	19.08.2024	<p>Përshëndetje</p> <p>Në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana juaj, ju bëjmë me dije se informacioni është në kompetencë të Autoriteteve Vendore, konkretisht Bashkisë Tiranë.</p> <p>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin</p>	Bashkisë Tiranë (19.08.2024)	Nuk ka
25	20.08.2024	<p>Përshëndetje!</p> <p>Nisur nga konstatimet e Shërbimit Veterinar Berat mbi problematikën e hasur me gjenerimin e mbetjeve shtazore jo për konsum human gjatë therjeve të bagëtive të imta (kurbaneve) në pelegrinazhin e Besimtarëve Bektashinj në Malin e Tomorit të cilat theren në dy pika therje dhe</p>	20.09.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Ju njoftojmë se nga verifikimet e kryera në terren në Parkun Kombëtar Mali i Tomorit si rezultat i kontrollit të kryer nga Inspektoratit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) është vendosur masë administrative me gjobë për subjektin e përfshirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	Kthim përgjigje (20.09.2024)	Nuk ka

		<p>jashtë tyre është konstatuar se këto mbetje shtazore groposen.</p> <p>Këto pika nuk janë të licencuara dhe gjithashtu nuk ka kompani Renderingu për marrjen dhe përpunimin e këtyre mbetjeve. Nisur nga ky fakt ne si shërbim veterinar nuk mund të kryejmë kontrolle të mbetjeve shtazore jo për konsum human dhe për këtë arsye kërkojmë nga ana e institucioneve tuaja marrjen e masave për këtë ndotje mjedisore.</p> <p>Bashkëlidhur konstatimin e Shërbimit Veterinar Berat. Faleminderit,</p>		<p>Kjo masë është marr pas konstatimit të shkeljeve përkatëse gjatë inspektimit, siç jeni vënë në dijeni dhe me shkresë zyrtare.</p> <p>Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,</p>		
26	28.08.2024	<p>Kërkesë e dërguar me postë</p> <p>Kërkesë për vendosjen ne dispozicion të praktikës njësuar me origjinalin të vendosur nga IKMT.</p>	04.09.2024	<p>Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin si më poshtë:</p> <p>Autorizim Inspektimi nr. IKMT-DI-2023-000072-1 Listë Verifikimi. Procesverbal Inspektimi nr. IKMT-DI-2023-000072-2 Urdhër nr 26 Sekuestro Sendi Nr. 1881/1 Prot. Urdhër nr 29 Nr. 188/7 Prot. Dërgim vendimi përfundimtar nr. 188/18 Prot. Kërkesa për shpallje nr. 200 Prot. Kthim përgjigje nga Bashkia Dibër.</p>	Kthim përgjigje 15.10.2024	Nuk ka

				Kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi nr.875 Prot Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.		
27	01.10.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Duke ju uruar punë të mbarë, në vijim të këtij komunikimi të mëparshëm, ju kontaktoj sërish për t'ju njoftuar se shifrat që ju vendosët në dispozicion do të përdoren në një artikull investigativ të INA MEDIA (Investigative Network Albania). Duke marrë në konsideratë diferencën e ndjeshme të penaliteteve në numër gjobash dhe vlerë, për të njëjtin 5 mujor, nga viti 2023 në vitin 2024, pyesim institucionin tuaj:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Si e shpjegoni një diferencë të tillë? A ka ndonjë tregues sektorial që sjell sipas jush këtë realitet numerik? 2. A është ndikuar institucioni juaj nga fakti që në vitin 2023 kishte fushatë zgjedhore për të “frenuar” ndëshkimin e qytetarëve apo subjekteve? 	15.10.2024	<p>E nderuar</p> <p>Në vijim të informacionit të dërguar në lidhje me kërkesën për numrin e gjobave të vendosura nga institucioni i IKMT- së për periudhën janar-maj 2023 dhe janar-maj 2024 informojmë si më poshtë:</p> <p>Referuar pyetjes se si shpjegohet një diferencë e tillë dhe ka ndonjë tregues sektorial që sjell këtë realitet numerik ju bëjmë me dije se:</p> <p>Puna e IKMT-së nuk ka tregues të veçantë sektorial që ndikojnë në rritjen apo uljen e numrit të gjobave por varet nga inspektimet në terren të cilat realizohen dhe kryhen në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar që ndërtimet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe kërkesat për bashkëpunim nga institucione të ndryshme.</p> <p>Vlen për tu përmendur që në periudhën e raportimit janar-maj 2024 apo (dhe në periudha të mëparshme) IKMT ka qenë e përfshirë në lirim të shesheve për disa projekte me interes publik, të</p>	Kthim përgjigje 15.10.204	Nuk ka

		Përgjigjet ose mospërgjigjet tuaja do të përfshihen në artikull. Ju falënderoj!		<p>cilat kanë çuar në një rritje të madhe të numrit të inspektimeve dhe procedurave të mbajtura nga IKMT.</p> <p>Gjithashtu referuar pyetjes suaj të dytë ju bëjmë me dije se Institucioni i IKMT-së operon në mënyrë të pavarur nga fushata zgjedhore dhe është e fokusuar në përmbushjen e objektivave për mbrojtjen e territorit dhe ndëshkimin e paligjshmërisë në fushën e ndërtimit.</p> <p>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.</p>		
28	12.11.2024	<p>Përshëndetje!</p> <p>Referuar ankesës së ardhur në Platformën e Bashkëqeverisjes ku është regjistruar Çështja Nr. 893405, e cila është përcjell nga institucionet sipas komunikimeve me e-mail (bashkëlidhur) nga një banuese përballë Stadiumit "Flamurtari" në lagjen "Pavarësia", Vlorë, ku pretendohen tymra/aroma të pa këndshme të çliruara nga tubat e aspirimit dhe prania e peshkut dhe pulave të pjekura mbetjeve të tyre, jashtë ambienteve të Restorant "BIG FAMILY", në katin e I të pallatit, i pa pajisur me leje mjedisore përkatëse dhe as</p>	12.11.2024	<p>Përshëndetje,</p> <p>Nëpërmjet këtij e-maili dëshirojmë t'iu informojmë se kërkesë/ ankesa, përcjell nëpërmjet e-mailit në adresë të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është marrë nga ana jonë.</p> <p>Gjithashtu Ju</p>	Delegim në DRIKMT Vlorë	Nuk ka

	<p>nuk pajiset me një të tillë.</p> <p>Ju bëjmë me dije sërish që institucioni ynë nuk është kompetent për rastin në fjalë, siç e kemi bërë të qartë dhe herët e tjera kur na është përcjellë ankesë mbi këtë subjekt, sipas akteve bashkëlidhur !</p> <p>Bazuar në: Urdhrin e Inspektoratit Qendrorë Nr. 29, datë 30.08.2023 “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushën e veprimtarisë inspektuese të mjedisit për Inspektoratin Kombëtarë të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”, Pika 3: “..., reciprokisht inspektorët e AKM, nëse marrin indicie, apo konstatojnë në flagrancë aktivitet mjedisor pa leje mjedisore, të njoftojnë Inspektoratin Qendror edhe inspektoratin e IKMT, për kompetencë”.</p> <p>Nenin 4 Pika 3 të Ligji Nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" i ndryshuar, i cili mes të tjerave parashikon se: “Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për masat që duhen marrë në kuadër të legjislacionit</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>të tyre të posaçëm, të cilat çojnë në ruajtjen ose përmirësimin e cilësisë së ajrit.”</p> <p>Sa më sipër në bazë të kompetencave të DREJTORISË RAJONALE TË IKMT- SË, VLOREË dhe BASHKISË VLOREË ju përcillet rasti për ndjekje dhe marrjen e masave sa më parë, si institucione kompetente. Punë të mbarë.</p>				
29	18.11.2024	<p>Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit</p> <p>Pyetje: A janë zhvilluar në dy vitet e fundit, inspektime të programuara ose rastësore në zonën e Kuçovës për subjekte që ushtrojnë veprimtari naftënxjerrëse duke pasur në konsideratë impaktin që ato kanë në mjedis? Nëse po, specifikoni kur janë zhvilluar këto inspektime? Si është paraqitur gjendja? Çfarë ka rezultuar gjatë zhvillimit të tyre? A keni lënë detyra për subjektet në rast se kemi konstatuar shkelje gjatë aktivitetit, etj?</p> <p>Na vendosni në dispozicion procesverbalet e mbajtura në të</p>	19.11.2024	<p>Përsëndetje, Bazuar në kërkesën për informacion nga ana juaj, pasi Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit kreu verifikimet ju bëjmë me dije se:</p> <p>Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka kryer kontroll në zonën e Kuçovës për subjekte që ushtrojnë veprimtari naftënxjerrëse duke pasur në konsideratë impaktin që ato kanë në mjedis.</p> <p>Gjatë vitit 2023 konkretisht në date 07.11.2023, Drejtoria Rajonale e IKMT Berat në bashkëpunim me Policinë e Shtetit konkretisht Komisarati i Policisë Kuçovë kanë ushtruar kontroll në qytetin e Kuçovës për shkak të ndotjes së një përroi si rrjedhojë e shkarkimit apo</p>	Kthim pergjigjeje (19.11.2024)	Nuk kaa

		<p>gjitha rastet e inspektimeve të kryera në zonën e Kuçovës për subjekte që ushtrojnë veprimtari naftënxjerrëse në vitin 2022, 2023 dhe 6 mujorin e parë në 2024.</p>	<p>derdhjes së naftës nga një subjekt me aktivitet në fushën e Hidrokarbureve, ku IKMT Berat ka ngritur grupin e punës në sektorin e mjedisit dhe ujrave për verifikimin dhe inspektimin në terren të problematikës.</p> <p>Nga verifikimet e kryera nga grupi i punës rezultoi se subjekti Albpetrol Sh.a, Dega: Qendra e Përpunimit të Naftës Kuçovë kishte kryer hedhje të një sasive të konsiderueshme të mbetjeve hidrokarbure në një përrua të qytetit duke sjellë ndotjen e tij në kundërshtim me ligjin Nr.10463 datë 22.09.2011, ‘‘Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve’’ dhe për këto arsye ndaj Qendrës së Përpunimit të Naftës Kuçovë, pjesë e shoqërisë Albpetrol Sh.A, nga ana e grupit të punës u vendos masa administrative gjobë Vendim Përfundimtar Nr.IKMT-BR-2023-000093-5, në masën 1.000.000 lekë.</p> <p>Në lidhje me këtë shkelje IKMT Berat gjithashtu ka vendosur në dijeni edhe ARM/Berat/Elbasan/Korçë. Gjithashtu sipas Udhëzimit Nr.29., date 30.08.2023, të Inspektoratit Qendror, Agjencia Kombëtare/Rajonale e Mjedisit ushtron inspektim në subjektet që</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>operojnë me lejet përkatëse mjedisore dhe verifikon kushtet e përcaktuara në leje.</p> <p>Pra subjektet të cilat operojnë me leje mjedisore janë subjekt inspektimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.</p> <p>Faleminderit</p>		
30	18.12.2024	<p>Për dijeni,</p> <p>Drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, , Drejtor i Inspektim Kontrollit,</p> <p>Me datë 08.11.2024, Agjensia Kombëtare e Mjedisit, ka dërguar një shkresë me numër protokolli 11837, ku kërkon bashkëpunimin e Bashkisë Lezhë, IKMT Lezhë, Policisë Lezhë dhe Ujësjiellës Kanalizime Lezhë për zbatimin e vendimit për pezullimin e shkarkimeve të subjektit INCA në kanal, pasi ka konstatuar se shkarkimet janë mbi normat e lejuara ligjore.</p> <p>Që nga ajo ditë, fabrika ka vazhduar punën si zakonisht. Ne e kemi denoncuar disa herë në polici, por nuk ka ndodhur asgjë. Po ju dërgoj linkun e emisionit investigativ Piranjat ku tregohen shkarkimet në kanal dhe hidhen</p>	18.12.2024	<p>Përshëndetje ,</p> <p>Drejtuar: Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Lezhë</p> <p>Në adresën e e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur kërkesa, me nr. 30 Rendor, datë 18.12.2024, për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>Bashkëlidhur po ju përcjellim kërkesën e paraqitur.</p> <p>Lutemi në trajtimin e kërkesës së sipërcituar.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,</p>	Delegim ne IMT Bashkia Lezhe	Nuk ka

	<p>poshtë pretendimet e subjektit se nuk janë shkarkimet e tij (https://www.youtube.com/watch?v=fRyh_Gjni-0).</p> <p>Me 23 Nëntor kemi protestuar para Policisë Lezhë. Një përfaqësues i policisë u takua me ne dhe na tha se do mblidhte institucionet për ta zbatuar vendimin. Që nga ajo ditë, fabrika ka vazhduar sërish punën si normalisht. Sot, me 18 Dhjetor, ne shkuam te IKMT Lezhë dhe Ujësjetllës Kanalizime Lezhë dhe i pyetëm për ecurinë. Një përfaqësues i UK Lezhë na tha se nuk kishin absolutisht të bënin me këtë vendim. Ndërsa përfaqësuesit e IKMT Lezhë na thanë se nuk i kishin mjetet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit dhe i kishin dërguar shkresë AKM duke ju kërkuar që ta adresonin kërkesën e tyre te Drejtoria qendrore e IKMT.</p> <p>Nga Bashkia Lezhë, Policia Lezhë, IKMT Lezhë dhe Ujësjetllës Kanalizime Lezhë, kërkoj të di: cila ka qenë arsyeja e mosveprimit tuaj deri tani? Ju lutem na dërgoni shkresat ku arsyetoni mosveprimin tuaj.</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>Nga Z. Mengri dhe Z. Banushi, kërkoh të di: cilat janë mjetet e nevojshme për ta kryer këtë punë? Nëse është e vërtetë se IKMT Lezhë nuk i ka mjetet e nevojshme për ta zbatuar vendimin, a mund ta merrni ju përsipër ta zbatoni vendimin?</p> <p>Znj. Dollani dhe Z. Seferaj, vendimi juaj nuk po zbatohet. Si mund të veproni për ta përshpejtuar zbatimin e këtij vendimi dhe ta ndalim këtë ping-pong institucional që po dëmton shëndetin e banorëve të Lezhës?</p> <p>Kërkojmë mbi të gjitha pak empati njerëzore. Është sfilitëse ta bëjmë ne qytetarët punën tuaj. Është revoltuese.</p> <p>Në pritje të përgjigjes tuaj,</p>				
--	--	---	--	--	--	--

Shënim:

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesave

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.